



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 610-35433 dt. 13 07 2022

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjes Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të *nenit 12* dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe në bazë të rekomandimit të Drejtorisë së Arsimit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022, të miratoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Neni 1

Më këtë vendim kërkohet ndërrimi i statusit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar- Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMLP) "Fehmi Lladrovci" të kalojë në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP)

Neni 2

Ky ndërrim i statusit ndikon në hapjen e drejtimeve dhe profileve të cilat janë si rrjedhojë e analizës së nevojave të tregut të punës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Shkolla.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Arsyetimi

Këshilli drejtues i SHMLP “ Fehmi Lladrovci “ në Drenas, me propozim e datës 20.06.2022 të drejtorisë së shkollës për ndërrimin e statusit, në mbledhjen e datës: 19.05.2022 ka marrë vendim nga Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMLP) të kaloj në Institucionin Arsimor për Arsimit dhe Aftësim Profesional (IAAP).

Ndërrimi i statusit të institucionit arsimor publik parauniversitar nga SHMLP në IAAP, ka përparësi të mëdha sa i përket hapjes së drejtimeve dhe profileve të cilat janë kërkesë e tregut të punës duke u bazuar në Ligjin nr.04/L032 e arsimit parauniversitar dhe Ligjin nr.04/L-138 për arsimin profesional .